


Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit: Ministria për Kthim dhe Komunitete	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Visar Basha – Ekspert shqyrtues i prokurimit 		
Lënda:	Ekspertiza lidhur me Ankesën Nr. 43/17 e OE “Besi” - Prishtinë.		
Datë:	22.02.2017		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik të Kosovës ju njoftojmë me raportin e ekspertizës, lidhur me ankesën e parashtruar me dt: 10.02.2016 me Nr. 43/17 nga OE “Besi” - Prishtinë, për shqyrtimin e lëndës: **“Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të MKK-së”** me numër të prokurimit: 211/16/274/221, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria për Kthim dhe Komunitete**.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.


Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA PËR KTHIM DHE KOMUNITETE.**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP.**
- OE ankues – **BESI.**

Raporti i ekspertit shqyrtues për lëndën: **“Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të MKK-së”** me numër të prokurimit: 211/16/274/221, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria për Kthim dhe Komunitete.**

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

	15.02.2017	05.02.2017	22.02.2017
<i>Nënshkrimi i ekspertit</i>	<i>Data e autorizimit të eksp.</i>	<i>Data e fillimit të ekspertizës</i>	<i>Data e dorëzimit të raportit</i>

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën 10.02.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. 43/17 e parashtruar nga OE **“Besi”**, me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të MKK-së”** me numër të prokurimit: 211/16/274/221, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria për Kthim dhe Komunitete.**

Konform nenit 113 te Ligjit Nr. 04/L-042, Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Ministrisë për Kthim dhe Komunitete.**

N.111 i LPP-së - Operatori Ekonomik Ankues “Besi”, me seli në Prishtinë.

Pikat e Ankesës nga OE “Besi” - dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:

- Neni 1 - Qëllimi;
- Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;
- Neni 61 – Tenderët jo-Normalisht te ulët;
- Rregullat për tenderët Jo-Normalisht te ulet.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

I pakënaqur ne vendimin nr.64 te dates 03/02/2016 nga AK ku hudh poshtë si te pa lejuar kërkesën për rishqyrtim ne afatin e lejuar ushtroje këtë: ANKESE te vendimin per shkak:

- Konstatimit te gabuar te gjendjes faktike
- Aplikimit te gabuar te te drejtës materiale.

Arsyetim

Me datën 27/01/2017 kemi pranuar nga ana e AK. Letrën Standarde për tenderuesin e pasuksesshëm për projektin **“Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të MKK-së”** Nr.prok.; 211-16-274-221.I me arsyetim:”Me keqardhje ju njoftojmë se tenderi i paraqitur nga ana juaj nuk qe i suksesshëm, ngase tenderi juaj nuk qe tenderi me çmimin më të ulët në mesin e tenderëve që plotësonin kërkesat e dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit dhe Ju informojmë se kontrata i është dhënë D.P.Z “Suzuki” për një shumë prej 30,491.60 €.

AK ka shkelje te Nenit 59-Ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi i tendereve e sidomos Nenin 61-Tenderët Jo-Normalisht të Ulët si dhe Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët Legjislacioni sekondar i cila ka hy ne fuqi 07/07/2016. Bazuar ne procesin e hapjes se ofertave nga numri i ofertave te pranura dhe nga çmimet e ofruara nga tre operatoret ekonomik te cilit kan aplikuar ne kete procedure te prokurimit, ne kemi verejt se nje oferte eshte me çmim ekstrem jo normalisht e ulte dhe

sipas kesaj mendojme qe kjo procedure e prokurimit nuk eshte vleresuar sipas LPP te Kosoves. Me qellim qe te kemi elemente te mjaftueshme per shqetesimet tona per tenderin jo normalisht te ulte ne kemi bere kerkese te AK me daten 29/01/2016 per qasje ne dokumentacionin e OE te rekomanduar per kontrate dhe me daten 02/02/2016 AK na ka lejuar qe te kemi qasje ne dokumentacionin e OE te rekomanduar per kontrate. Gjate kontrollit te dokumentacioni te OE kam kerkuar nga zyrtari i prokurimit a keni pas korospondime me OE Suzuki ne lidhje me çmimet e ofruara dhe nese keni pas na i trego mirepo zyrtari i prokurimit me tha qe nuk ka pas kurfar korospondimi pasi nuk kemi kerkuar sqarime per çmimet e ofruara. Komisioni i vleresimit nuk e ka zbatuar nenin 61 te LPP si dhe Tregulloren per tenderet jo normalisht te ulet. Sipas rregullave nje nga anetaret e komisionit eshte dashte te jete edhe ndonje zyrtar i prokurimit me qellim qe komisioni gjate vleresimit mos te bene ndonje shkelje te rregullores se prokurimit dhe sipas rezultatit po verehet qe zyrtari i prokurimit nuk e ka zbatuar rregulloren per tenderet jo normalisht te ulte. AK ne Vendim te cilin e refuzon kerkesen per rishqyrtim konstaton “zyra e prokurimit ka konstatuar: Komisioni i vleresimit ka vepruar konform dispozitave te nenit 59 si dhe konform Udhzuesit operative te prokurimit publik dhe ne harmoni me nenin 61 te LPP se AK ka vlersuar se çmimet e OE te rekomanduar per kontrate jane ne pajtueshmeri me çmimet e tregut dhe ju rikujtojme se e drejta per vleresim sipas nenit te larte cekur te çmimeve eshte e drejte ekskluzive e AK.” Askund ne ligj nuk shkruan se e drejte ekskluzive per vleresim te çmimeve eshte e drejte e AK. Nese i referoheni ketij konstatimi ateherë na bene me shume te dyshojme ne subjektivizem dhe ne korupcion. (“ nga kjo lind dyshimi pse vetem ky OE ka vendos çmime gati dy here me te vogla se sa te palnifikuara me buxhet ndersa dy OE kan tejkaluar buxhetin e parapare neri rreth 7,000.00 e tjetri per 12,000.00 € ndersa dhe ate a nuk lindi dyshimi qe jan marr vesh”). Nga kjo shifet qarte qe AK fare nuk e ka respektuar nenin 61 te LPP dhe fare çmimet e ofruar nuk jane çmime te tregut apo çmimeve referente te botuara ne KRPP te cilat nuk jane obligative por te cilat eshte dashte komisioni qe ti merr per baze. Bazuar ne vendimin e AK neve na shpallte papergjegjshem ndersa me daten 27/01/2017 na njoftoni me “Letren Standarde per tenderuesin e pasukseshem” qe jemi te pergjegjshem por çmimi ka qene me i larte per tenderin e lartepemendur dhe çka eshte edhe me ironike AK ne vendim shkruan Ankesa e juaj hidhet posht si e pa lejur ne baze te nenin 111 pika 1.5 dhe 1.8 per faktin se nuk keni arritur te deshmoni interes materialojuridik pasi qe jeni i pa pergjegjshem ne baze te arsyeve te larte cekura dhe ne asnje rrethane nuk mund te jeni nenshkruet i kesaj kontrate dhe ne asnje rrethan nuk cenohet interesi i juaj materialo juridik edhe sikur i njejti aktivitet te kthehet ne rivleresim prap se prap ju do te jeni i papergjegjshem. Me kete shprehje dhe me keto konstatime te cilat i jep zyrtari i prokurimit fitohet pershtypja se institucionin eshte prone e tij. Ne mos me pas interes materialo juridik nuk kishim aplikuar fare ne kete procedure te prokurimit. Mirepo eshte e pajustificueshme konstatimi i AK qe çmimet e ofruarjane ne harmoni me çmimet e tregut ndersa asnje element nuk na jep qe jan ne harmoni me çmimet e tregut. Operatori ekonomik i rekomanduar per kontrate nga shume pozicione te cilat ka manipuluar me çmime dhe eshte per qudi se si AK thot qe jane çmime te tregut eshte e patolërueshme une po e elaboroj vetem nje çmim. Pozicioni “pune dore” OE ka vendosur çmimin 40.00 €. Po si mundet AKta trajton kete çmim te tregut ne Kosove sikur ky çmim te ishte ne Zvicer prap kishte menduar njeriu mirepo ne Kosove kesi çmimi nuk ka pas dhe nuk ka e si eshte duke shkuar situata edhe 50 vjete kete çmim ne nuk mund ta arrijme. Mandej se sa eshte manipulativ ne çmime verhet edhe te puna dore per tipet e automjeteve. Nga te gjitha tipet e automjeteve 13 cope per 11 automjete puna dore eshte 40,00 € ndersa per dy ndryshon per Toyota Piccap çmimi eshte 15,00 € dhe per Mitsubishi çmimi eshte 25.00 €. Paramendoni çfare pagash duhet ti kene aty ata punetore me kete çmim. OE ka manipular me çmime ku ka llogarite qe te perfiton vetem nga puna e dores prandaj edhe mu per kete OE ka dal me çmime jo noramalishte i ulte. Sipas Ligjit te prokurimit Neni 61 Tenderet Jo normalishte te ulet si dhe rregullorja per tenderet jo normalisht te ulte Neni 3 dhe Neni 4 ku sqaron ne detale se si te veprohet per tenderet jonormalisht te ulet. Nese e kishin krahasuar me shembullin shkollor i cili gjendet ne rregullore automatikisht kane mundur qe kete OE ta shpallin si te papergjegjshem. Nga Çmimet e

ofruara te tre aplikuesve: OE -1- vlera ka qene 30,491.60 €; OE-2-vlera ka qene 59.954.60 € dhe OE-3 vlera ka qene 64,273.80 e qe vlera totale eshte 154,720.00 €/3 OE mesatarja eshte 51,573.33 e nga kjo rrjedh qe operatori i rekomanduar per kontrate Suzuki ka ofruar çmimin ekstrem te ulte: 30,471.60 € çmimi jo qe eshte me i vogel por eshte 60% me i ulte se mesatarja e te gjithë operatoreve ekonomik te cilit kan aplikuar ne kete tender. Sipas rregullores B57- Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët Neni 4-procedura e shqyrtimit (interpartes) pika 4.2. shkruan Në rast se një tender (apo një pozicioni tenderit) duket të jetë abnormalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo-normalisht i ultë, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë. Prandaj justifikim i AK eshte i pa baze si dhe na bene te dyshojme ne subjektivizem, pasi ne para se gjithash e njofim ndersa dyshimi eshte edhe me shume i bazuar ne çmime te manipuluar kur eshte fjala per origjinalitetin e pjeseve kur dihen procedurat e furnizimeve me pjese origjinale te paperdorura, transportit, doganave TVSH-etj.(Nje nga kriteret ka qene qe “Çmimet e ofruara duhet të jenë ekuivalente me çmimet e tregut” Çmimet nuk jane te peraferta me çmimet referente te botuara ne KRPP as me çmimet e tregut.Prandaj duke u bazuar ne te gjitha qe u ceken mendojme se kjo procedure e prokurimit gjegjesishte vleresimi i tenderave nuk eshte bere sipas LPP te Kosoves dhe KERKOJME qe te anulohet Vendimin per dhenje te Kontrates, ta shpall te papergjegjshem OE te rekomanduar per kontrate dhe ta kthej kete procedure te prokurimit ne Rivlerësim. Bazuar ne LPP tenderi i jone duhet te shpallet perfitues.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP : 05.12.2016

Lloji i procedurës së aplikuar:..... Procedurë e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:Shërbime/vlerë e mesme

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë):27.12.2016

Data e hapjes së ofertave27.01.2016-14:30ⁿ

Kriter për dhënie të kontratës:.....Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët

Kriteret për vlerësim

III.2)KUSHTET PËR PJESËMARRJE KËRKESAT E PËRSHTATSHMËRISË:

1.Deklaratë nën betim - Operatori ekonomik duhet ti përmbushë kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042, Neni 65 duke përdorur formën në Aneksin 2

2.Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e Kosovës e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit. Duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës

3.Vërtetimin nga Gjykata themelore - Një formular ekstrakt nga “regjistri gjyqësor” apo, në mungesë të kësaj, një dokument ekuivalent të lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ i shtetit të themelimit të tenderuesit ku dëshmohet për Seksioni II. FLETA E TË DHËNAVE të Tenderit (FTD) të dosjes se tenderit te Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik, (shiko dosjen e tenderit pjesën 6.4. Duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Raporti i ekspertit shqyrtues për lëndën: “Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të MKK-së” me numër të prokurimit: 211/16/274/221, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria për Kthim dhe Komunitete.

Deklaratë nën betim - origjinal

Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e Kosovës

Vërtetimin nga Gjykata themelore (Origjinal ose kopje e noterizuar)

PËRSHTATSHMËRIA PROFESIONALE

1. Certifikata e regjistrimit të biznesit

2. Certifikata e regjistrimit të TVSH-së

3. Certifikata e regjistrimit të numrit fiskal.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Certifikata e regjistrimit të biznesit (kopje)

Certifikata e regjistrimit të TVSH-së (kopje)

Certifikata e regjistrimit të numrit fiskal (kopje).

KAPACITETI EKONOMIK DHE FINANCIAR

1. Të hyrat e përgjithshme së bashku për tre (3) vitet e fundit (2013-2014-2015) duhet të jenë minimum 104,000.00 €

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Nga ndonjë bankë e licencuar në Kosovë.

KAPACITETI TEKNIK DHE PROFESSIONAL

1. Lista e kontratave me referenca të cilat saktësojnë shërbimet e realizuara lidhur me servisimet e veturave ose të ngjashme .

2. Hapësira e objektit-ve (servisit-ve) duhet të jetë e mjaftueshme. Kjo hapësirë duhet të jetë e mbyllur dhe e mbrojtur nga ndikimet e faktorëve jashtëm siç janë reshjet, era , pluhuri etj.

3. Vinça hidraulik për ngritjen e automjeteve - minimum dy (2) vinça

4. Paisje për riparimin (vullkanizimin) e gomave

5. Paisje speciale për diagnostifikimin e defekteve të automjeteve.

6. Paisje speciale për riparimin e klimave të automjeteve

7. Automjet për bartjen – tërheqjen e automjeteve në rast defekti në rrugë

8. Mekanik (punëtor) për riparimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve - minimum tre (3)

9. Një deklaratë lidhur me mjetet, vendin apo pajisjet teknike në dispozicion për operatorin ekonomik për kryerjen e shërbimeve në fjalë.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Lista e kontratave me referenca të cilat saktësohen shërbimet e realizuara lidhur me servisimet e veturave ose të ngjashme (llogariten kontratat dhe referencat të cilat kanë të bëjnë me servisim të automjeteve ose të ngjashme)- e nënshkruar dhe e vulosur- origjinal. Së paku tri referenca gjatë tri viteve të fundit (2013 – 2014 – 2015)

Të dëshmohet me fotografi dhe dokumentacion tjetër dëshmues

Të dëshmohet me fotografi

Të dëshmohet me fotografi

Të dëshmohet me fotografi

Të dëshmohet me fotografi

Të dëshmohet me fotografi dhe librezë të regjistrimit të automjetit

Të dëshmohet me CV, kontratat

E nënshkruar dhe e vulosur origjinal.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatorët ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €	Vërejtje
1.	“Suzuki”	Prishtinë	30,491.60€	JO
2.	“Besi”	Prishtinë	59,954.60€	JO
3.	“Europa”	Prishtinë	64,273.80€	JO

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- Aleksander Dekic - Kryetar i komisionit
- Dejan Spasojevic - Anëtar i komisionit
- Ridvan Islami - Anëtar i komisionit

Data e mbarimit të vlerësimit:27.01.2017

Data e nënshkrimit të raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....27.01.2017

Data e njoftimit të Dhënies së Kontratës në faqen e Krpp-së :.....30.01.2017

Sipas raportit të komisionit të vlerësimit ofertat të PËRGJEGJSHME janë:

Nr.	Emri i tenderuesit të Përgjegjshëm	Çmimi i ofruar	Radhitja sipas çmimit
1.	Suzuki	30,491.60€	1

Raporti i komisionit vlerësues:

Pas ekzaminimit dhe vlerësimit të tenderëve komisioni konstaton se OE Suzuki, i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Neni 54 i LPP-së – Njoftimi i kandidatëve - Tenderuesve

AK-ja, konform nenit 54 të LPP-së dhe nenit 37 të Udhëzuesit Operativ për Prokurimit Publik, i njofton operatorët ekonomik me letrën standarde.

Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Pas pranimit të letrës standarde OE ankues konform nenit 108/A ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, me ç'rast AK-ja, e hudh poshtë ankesën e OE ankues “Besi” si të pa lejuar, me arsyetimin se OE “Besi”, e ka tejkaluar vlerën e parashikuar për këtë projekt.

Përgjigjet e ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimet ankimore të OE ankues:

Sqarimi nr.1

Eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja, pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, me vendim e shpall si të papërgjegjshëm OE ankues me arsyetimin se OE ankues, e ka tejkaluar vlerën e parashikuar për këtë projekt.

Sqarimi nr.2

Eksperti shqyrtues, pas analizimit të shkresave të lendes sqaron se në njoftimin për kontratë dhe në Dosje të Tenderit në pikën: 2.4, për këtë projekt AK-Ministria për Kthim dhe Komunitete e ka dhënë vlerën e parashikuar prej: 52,000.00€.

Sqarimi nr.3

Eksperti shqyrtues, sqaron se sipas procesverbalit të hapjes publike, rezulton që oferta e OE ankues “Besi” është 59,954.60€ (i dyti me radhë sipas çmimit), ndërsa operatori ekonomik “Europa” 64,273.80€ (i treti me radhë sipas çmimit). Sipas çmimeve të ofruara të dy operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit janë mbi vlerën e parashikuar të kontratës.

Në vazhdim eksperti shqyrtues sqaron se AK-MKK-ja, me të drejt e eliminon OE ankues, nga ky aktivitet i prokurimit, për faktin se OE ankues e ka tejkaluar vlerën e parashikuar. Eksperti shqyrtues, sqaron se tejkalimi i vlerës së parashikuar nga një operator ekonomik e bën të papërgjegjshëm dhe me këtë rast OE ankues nuk mund të dëshmojë interes juridik e material konform nenit 4.1.26 dhe nenit 111.1.5 dhe 1.8 të LPP-së.

Sqarimi nr.4

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues, pretendon se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar çmim Jo-Normalisht të ulët dhe se AK-ja, nuk e ka aplikuar rregulloren për çmime Jo-Normalisht të ulëta.

Eksperti shqyrtues, sqaron se ky pretendim i OE ankues është i paqëndrueshëm për faktin se sipas Rregullores për çmime Jo-Normalisht të ulëta, kushti i parë për tu aplikuar kjo Rregullore duhet që të jen tri oferta e në rastin konkret vetëm një ofertë është e përgjegjshme, gjë që nuk mund të aplikohet formula e dhënë në këtë Rregulloren për çmime Jo-Normalisht të ulëta. Andaj, pretendimet ankimore të OE ankues për shkelje të dispozitave të LPP-së janë të paqëndrueshme.

Mendimi i ekspertit shqyrtues :

- Eksperti shqyrtues bazuar në konstatimet e cekura në ekspertizë mendon që Autoriteti Kontraktues – **Ministria për Kthim dhe Komunitete**, për aktivitetin e prokurimit **“Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të MKK-së”** me numër të prokurimit: 211/16/274/221, i ka respektuar dispozitat e LPP-së.
- Prandaj eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ta aprovojë vendimin e AK-së për dhënie të kontratës dhe njëherit propozon që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar.